



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:132902
Datë: 14.09.2022
Numri i dokumentit: 03419575

PKR.nr.92/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Krimeve të Rënda, trupit gjykues i përbërë nga gjyqtarët **Drilon Haraçia** - Kryetar i trupit gjykues, gjyqtarëve profesional – **Nikollë Komani dhe Shaqir Zika** - anëtarë të trupit gjykues, me zyrtaren ligjore Arbënore Basha, në çështjen penale kundër të akuzuarit V. (B.) K. nga fsh. . . , Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 216 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Krimeve të Rënda, me numër PP/I.nr.129/2022, të datës 27.06.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor – publik me datën 13.10.2022, në prezencën e Prokurores së Shtetit Dëshire Jusaj dhe të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av.Bekim Kryziu nga Malisheva, sipas autorizimit, në të njëjtën dite mori dhe publikisht shpalli, ndërsa e përpiloi **me dt.14.10.2022**, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

V. K., nga i ati B. dhe e ëma H. e gjinisë H. Data e lindjes . . . në fshatin . . . Komuna e Malishevës, ku edhe banon rr. “. . .” p.n, me nr. personal: . . ., i martuar atë i dy fëmijëve, ka të kryer Fakultetin Ekonomik- Drejtimi për Banka, Financa dhe kontabilitet, i punësuar në KRK-në, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me dt.06 Tetor 2019 në shkollën fillore “. . .” në fsh. . . , Komuna Malishevë pas mbylljes së vendotimeve pas orës 19:00/h, duke keqpërdorur pozitën apo autorizimin e tij lidhur me zgjedhjet ka regjistruar në mënyrë të pasaktë rezultatet e zgjedhjeve në dokumentet zgjedhore, në atë mënyrë që i pandehuri ditën kritike ku ishte i autorizuar nga KQZ si kryesues i komisionit zgjedhor në vendvotimin me numër 3008A/03R që gjendej në shkollën fillore “. . .” në fsh. . . K.Malishevë , pikërisht pas numërimit të votave në FRK (Formularin i Rezultateve të Kandidatëve) në kundërshtim me nenin 102 par.2 të Ligjit NR.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ka regjistruar në mënyrë jo të saktë votat e kandidatëve, përkatësisht ka regjistruar në mënyrë të parregullte gjithsej 430 vota, prej tyre 251 vota të shtuara dhe 179 vota të hequra, me ç ‘rast në gjithsej 430 vota i ka dëmtuar kandidatët e ndryshëm brenda subjekteve politike për zgjedhjet e përgjithshme, gjendje kjo e konstatuar edhe nga raporti policor i dt. 03.06.2022 nga rinumërimi i bërë me dt. 31.05.2022.

- **Me çka ka kryer veprë penale falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 216 par.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 50, 60, 63, 69, 70, dhe nenit 216 par.1 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

D Ë N I M I N M E K U S H T

Duke ia vërtetuar **dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti**, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Ndaj të akuzuarit V. K., i shqiptohet edhe

D Ë N I M I P L O T Ë S U E S

NDALIMI – HEQJA E TË DREJTËS PËR TU ZGJEDHUR DHE NDALIMI I USHTRIMIT TË PROFESIONIT, I VEPRIMTARISË OSE DETYRËS, ashtu që i ndalohet e drejta për tu zgjedhur si kandidat për zgjedhjet Lokale apo Qendrore në Republikën e Kosovës, po ashtu i ndalohet ushtrimi i detyrës që të marrë pjesë në zgjedhje lokale apo qendrore si vëzhgues, kryesues, komisioner apo pozita tjera apo të ngjashme të cilat kanë të bëjnë me zgjedhjet lokale apo qendrore të organizuara nga KQZ-ja, në kohëzgjatje **prej 4 (katër) vite**, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Detyrohet i akuzuari V. K., që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 50 (pesëdhjetë) Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 50 (pesëdhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/I.nr.129/2022, të datës 27.06.2022, kundër të akuzuarit V. (B.) K. nga fsh. . . , Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 216 par.1 të KPRK-së.

Prokurorja e Shtetit Dëshire Jusaj, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit të lartcekur, andaj ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari V. K., në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, ka shtuar se është penduar për veprën e kryer, i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tilla penale, duke i propozuar gjykatës që të ketë parasysh një dënim sa më të lehtë.

Prokurorja e Shtetit Dëshire Jusaj, lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e këtu të akuzuarit, pasi që i njëjti kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë me vetëdije dhe vullnet të plotë si dhe pas konsultimit me mbrojtësin e tij, po ashtu pranimi i fajësisë mbështetet në provat në të cilat mbështetet edhe aktakuza, i propozojë gjykatës që të aprovojë pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. Bekim Kryeziu nga Malisheva, lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se e mbështesë në tërësi deklaratën e të mbrojturit tim lidhur me pranimin e fajësisë, të njëjtën e ka bërë në konsultim paraprakisht me mua, dhe pranimi i fajësisë është bërë konform dispozitave ligjore andaj i propozojë gjykatës që ta aprovojë.

Në fjalën përfundimtare Prokurorja e Shtetit Dëshire Jusaj, ka deklaruar se gjendja faktike e përshkruar në aktakuzë dhe me vet faktin e pranimin të fajësisë në këtë shqyrtim gjyqësor u argumentua në ligj e i cili p pranimin i fajësisë ka mbështetje në të gjitha provat materiale e personale si në aktakuzë, dhe se nga të gjitha këto prova janë formuar edhe elementet e veprës penale falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 216 par. 1 të KPRK-së e të cilin pranimin të fajësisë këtu i akuzuari duke i ditur edhe pasojat e pranimin të kësaj fajësie bëri edhe pranimin e veprimeve të tij që rezultojnë në kryerje të veprës penale, andaj Gjykatës i propozojë që pas pranimin të kësaj fajësie i njëjti të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit duke e obliguar në kompensimin e shpenzimeve procedura, njëherë me rastin e matjes së dënimit të ketë parasysh krahas rrethanave lehtësuese edhe pranimin e fajësisë të merret si rrethanë lehtësuese.

Në fjalën përfundimtare mbrojtësi i të akuzuarit V. K., avokatit Bekim Kryeziu ka deklaruar se meqenëse i mbrojturi im qysh në fillim të shqyrtimit pranojë fajësinë më mbetet që të lus gjykatën që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese, pranimin e fajësisë, kërkim faljen publike, pendimin e tij të thellë, premtimin se i njëjtit nuk do të kryejë vepër penale tjetër, nuk ka qenë kurrë më parë i dënuar as nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale ndaj tij, ka qenë hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin. Ne e dimë se një ndër qëllimet e dënimit është rehabilitimi dhe pendimi i kryerësit të veprës penale në rastin konkret e shohim një pendim të thellë tek pala, kështu që çdo dënim sa më i lehtë e themi me bindje të plotë se do të arrinte edhe qëllimin e dënimit, andaj duke pasur parasysh të gjitha këto gjykatës i propozojmë që duke i zbatuar edhe dispozitat për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit të parapara me KPRK-ë të njetit ti shqiptojë një dënim të kushtëzuar.

Në fjalën përfundimtare i akuzuari V. K., ka deklaruar se e mbështesë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe shton se ndihem i penduar dhe kërkojë falje publike për kryerjen e kësaj veprë penale dhe premtojë se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tilla penale.

2. Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, trupi gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ngase ka ardhur në përfundim se pranimin i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimin të fajësisë, trupi gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimin është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, po ashtu pas konsultimeve me mbrojtësin e tij av. Bekim Kryeziu, pranimin i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, trupi gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se i akuzuari V. K., me dashje ka kryer veprën penale falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 216 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 216 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se këtë formë të kësaj vepre penale falsifikimi i rezultateve zgjedhore e kryen “*Kushdo që shton, heq apo fshin votat apo nënshkrimet, regjistron në mënyrë të pasaktë votën apo rezultatet e zgjedhjeve në dokumentet zgjedhore, ose publikon votën apo rezultatet e zgjedhjeve apo të votimit që nuk i përgjigjen votimit të vërtetë, ose në ndonjë mënyrë tjetër falsifikon votën apo rezultatet e zgjedhjeve, dënohet me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet. Kështu që duke u bazuar në këto dispozita ligjore, Gjykata, e ka shpallur fajtor të akuzuarin V. K., për shkak të veprës penale falsifikimi i rezultateve zgjedhore nga neni 216 paragrafi 1 të KPRK, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.*

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarës: jeton me 6 anëtare të familjes, i gjendjes së mesme ekonomike, mbajtës i familjes, nuk ka qenë asnjëherë i akuzuar për ndonjë vepër penale në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, kërkim faljen publike, koha e kaluar që nga kryerja e veprës penale. Si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë në shqyrtimin gjyqësor. Ndërsa si rrethanë rënduese kjo Gjykatë nuk gjeti për të akuzuarin. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 dhe 47 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

6. Dënimi plotësues

Gjykata sipas detyrës zyrtare, duke u bazuar në nenin 59, 60 dhe 63 të KPRK, përveç dënimit alternativ (dënimin me kusht), ndaj të akuzuarit V. K., iu është shqiptuar edhe dënimi plotësues heqja e të drejtës për tu zgjedhur dhe ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, në kohëzgjatje prej 4 viteve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Pra të njëjtit i ndalohet e drejta për tu zgjedhur si kandidat për zgjedhjet lokale apo qendrore në Republikën e Kosovës, po ashtu i ndalohet ushtrimi i detyrës që të marrë pjesë në zgjedhje lokale apo qendrore si vëzhgues, kryesues, komisionar apo pozita të tjera apo të ngjashme të cilat kanë të bëjnë me zgjedhjet lokale apo qendrore të organizuara nga KQZ-ja. Andaj, Gjykata e ka shqiptuar këtë dënim plotësues, siç parashihet edhe në nenin 59 paragrafi 1 dhe 2 nën par.2.1 dhe 2.4 të KPRK-së, Meqenëse “*Kryesit të veprës penale*” si në rastin konkret pasi që duke

shfrytëzuar pozitën e kryesuesit ka bërë falsifikimin e votave, gjykata mund t'ia shqiptojë dënimin plotësues duke vlerësuar se shqiptimi i këtij dënimi plotësues është i domosdoshëm për tu arritur qëllimi i dënimit.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.92/22, me datë 14.10.2022

Zyrtarja Ligjore,
Arbënore Basha

Kryetari i Trupit Gjyqësor- Gjykatësi,
Drilon Haraçia

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.